



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Durrës, më 09.07.2025

**PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Punë**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtim i Rrjetit të Kanalizimeve në Fshatin Rrushkull”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): Emërtimi dhe identifikimi i Kodi CPV- Punime ndërtimi për kanalizime 45232400-6.

VLERA E FONDIT LIMIT: 32.959,439.69 (tridhjetë e dy milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e nëntë) Lek pa TVSH.

Argumentim:

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË
KONTRATËS**

Në zbatim të urdhrat të grupit të specifikimeve nr.131, datë 30.05.2025 dhe nr.1290/7 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas buxhetit të Bashkisë Durrës për fondin limit.
2. Shqyrtoi dokumentat e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i punës.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i Specifikimeve Teknike pjesë e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sipas të cilit:

Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’ireferohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

a) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritetet tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Në përfundim të punës së grupit u vërejt se:

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin për projekt zbatimin e objektit: “Ndërtim i Rrjetit të Kanalizimeve në Fshatin Rrushkull”, të hartuar nga stafi i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 32,959,439.69 (tridhjetë e dy milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e nëntë) Lek pa TVSH.

Projekti do financohet në dy vite të ndarë, për vitin 2025 dhe 2026 nga buxheti i bashkisë.

Afati i realizimit të punimeve është 70 (shtatëdhjetë) ditë.

Garancia për mbulimin të defekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e firmës të jetë 2 (dy) vjet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 e 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP-së “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për

pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme, (sipas shtojcës 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni III, neni 43, pika 2 dhe 3 nenet 43 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe është në përpjesëtim të drejtë me fondin limit të procedurës. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e kopjes të deklarimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare: (2022, 2023, 2024), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të

kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti i tij) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si mëposhtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Referuar fondit limit sipas nenin 39 pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Aftësitë teknike dhe profesionale të tjerat si më poshtë janë hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. **NP. 1 A** – Punime gjërmimi në tokë
- b. **N.P. 4-A** – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- c. **NP-7 -A** – Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.
- d. **N.S-1-A** – Punime për prishjen e ndërtimeve.
- e. **N.S-6-A** – Sinjalistika rrugore jondriçuese
- f. **NS-18A** – Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të

zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreut V, Seksioni III, nenin 39, pika 6/a, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si edhe Vendimin nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, pikat e licencës dhe kategoritë me klasifikimet përkatëse caktohen duke u mbështetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektit dhe ne vlerën totale te punimeve për secilën kategori.

Kategoritë e poshtëshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PERSHKRIMI I KATEGORISË SIPAS LEGJISLACIONIT TË FUSHËS	ZËRAT E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE	NIVELI I KLASIFIKIMIT I KËRKUAR PËR KATEGORINË RESPEKTIVE	VLERA E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE
NP. 1-A	<i>Punime gërmimi në tokë;</i>	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke Germime dheu ne seksion te lire me krahe,ne toke te bute,kateg.I-II, trans.karro dore deri 10 m Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te zakonshme	A, 0-20 milion lek	3,642,263.82 LEK
NP.4 - A	<i>Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale</i>	Shtrese stabilizant t=10cm Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm Shtrese betoni C 16/20	A, 0-20 milion lek	4,911,385.97 LEK

		Shtrese betoni C 6/10 Soletë monolite C20/25		
NP. 7-A	<i>Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje</i>	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 150 cm Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 200 cm F.V tuba b/a Ø 1000 mm Pusete shkarkimi 50 x 50, h = 100 cm Ndertim Pusete kontrolli b/a, 1x1x2 m me kapak gize Ndertim drenazhi, mbushje me zhavorr + PVC 200 mm V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm V tuba betoni d=1000 mm F.V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm Germim me mikrotunel D=500mm per kalimin e tubit te polietilenit PEHD+rakorderi, me makineri me drejtim me lazer Pastrim me sonde presioni te larte mbi 250 bar te tubacioneve ekzistuese Grope septike 16 m3	A, 0-20 milion lek	12,436,078.28 LEK
N.S –1 A	<i>Punime për prishjen e ndërtimeve</i>	Prishje shtresa betoni Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km Prerje asfalti me disk, ne te dy anet.	A, 0-20 milion lek	1,537,208.10 LEK

N.S-6- A	<i>Sinjalistika rrugore jondriçuese</i>	FV tabela te medha informative te thjeshta + bazamenti	A, 0-20 milion lek	16,487.14 LEK
N.S.18-A	<i>Punime topogjeodezike;</i>	Është kërkuar për arësye të zbatimit të rlevimeve topografike që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë dhe punimeve topogjeodezike në objekt.		

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- b. Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- c. Inxhinier Gjeodet 1 (një)

Për këtë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

-kontratë individuale pune të vlefshme,

-diplomë përkatëse,

-librezë pune

-si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe

me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me sipër, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licencës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të rrjetit të kanalizimeve, si tubacione, puseta etj.
- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të trupit të rrugës, si hedhjen e shtresës së cakëllit, stabiliznatit. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve konkretisht cakëll, stabilizant si dhe për punimet e hekur betonit.
- **Inxhinieri Gjeodet** është kërkuar me qëllim realizimin e rëlevimeve topografike të domosdoshme gjatë zbatimit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës, (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diploma përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimum për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- a. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si “Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” bazuar në përlogaritjen e oreve të punës, kategorite e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zerave të punimeve, të cilat lidhen ngushtesisht me listën e stafit teknik të kerkuar nga AK, si edhe bazuar në dosmosdoshmerine e realizimit sa më shpejt të objektit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

Punonjës Staf Teknik:

- | | |
|---------------------------------|-------------|
| a. Teknik Ndërtimi | 1 (një) |
| b. Hidraulik | 2 (dy) |
| c. Karpentier | 2 (dy) |
| d. Hekurthyes | 2 (dy) |
| e. Shofer | 2 (dy) |
| f. Punëtor ndërtimi të thjeshtë | 10 (dhjetë) |

Punonjës Manovrator:

- | |
|-----------------|
| a. Eskavatorist |
| 2 (dy) |

Për keta punonjes, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument (diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.
- certifikate të sigurimit teknik të lëshuar nga shoqëritë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Për punonjësit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:
Kontratën individuale të punës të vlefshme; leje drejtimi, certifikate të aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shoferë janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).
- Për punonjësit Manovratorët duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor. Kërkesa për dëshmitë të manovratorëve bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastruktura dhe Energjisë nr.200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”
(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shoferë janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).
- Për punonjësit e krahut , ofertuesi duhet të paraqesë kontratën individuale të punës të vlefshme .

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikues ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas

Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantojë që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialistëve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve për thellimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriter elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

- **Karpentieret dhe hekurthyesit** janë të nevojshëm për punimet e armaturave të hekurit.
- **Manovratorët** janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve të rënda si eskavatori, rruli, autovinc etj
- **Drejtuësit** e mjetit janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamion dhe autobetoniere.
- **Hidraulikët:** Hidraulikët janë të nevojshëm për të garantuar instalimin e sistemeve të kanalizimit të ujërave të ndotura, përfshirë montimin e tubacioneve, kontrollin e pompave, dhe sigurinë e rrjedhës së ujit.
- **Teknik i mesëm të ndërtimit** janë të nevojshëm për të monitoruar dhe udhëhequr punimet në terren, duke siguruar që të gjitha fazat e ndërtimit të bëhen sipas projektit dhe standardeve teknike. Ata gjithashtu menaxhojnë koordinimin midis ekipeve të ndryshme dhe ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve teknike gjatë procesit të ndërtimit.
- **Punëtorët e thjeshtë të ndërtimit** janë të nevojshëm për realizimin e detyrave fizike dhe mbështetëse në ndërtimin e rrjetit të kanalizimit.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 25 (njëzet e pesë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për një periudhë 3 muajore nga data e zhvillimit të tenderit, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Operatori ekonomik krahas deklaratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.
- Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.

Numri prej 25 punonjës përfshin 22 punëtorë të cilët janë pjesë e stafit mbështetës dhe do të kryejnë operimin në terren dhe objekt + 3 personat që janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe i drejtuesve teknikë të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu për llogaritjen e numrit të punonjësve janë marre parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtoare, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre “(për llogaritja e oreve të Punes si edhe të mjeteve të nevojshme), Kodi i Punes në RSH, si edhe bazuar në dosmosdoshmerinë e realizimit sa më shpejt të objektit. Komisioni i përlllogaritjes së vlerës së fondit limit dhe përgatitjes së dosjes teknike kanë analizuar dhe përlllogaritur numrin minimal të punëtorëve prej 25 punonjësish mesatarisht të dosmosdoshëm për realizimin e objektit të prokurimit në një afat kohor 10 jave - grafik punimesh.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasi
1	Eskavator me zinxhir min 15 ton	Pronesi ose me qera	1 copë
2	Minieskavator me zinxhir gome	Pronesi ose me qera	1 copë
3	Mjet eskavator i pajisu me vibrator për ngulje palankolash	Pronesi ose me qera	1 copë
4	Fadrome me kove para dhe mbrapa me goma	Pronesi ose me qera	1 cope
5	Mini fadrome me kove para me goma	Pronesi ose me qera	1 cope
6	Kamion vetëshkarkues me masë maksimale të autorizuar (25-32) Ton	Pronesi ose me qera	2 copë

7	Kamion veteshkarkues me vinxh me kapacitet mbajtes min 7 ton	Pronesi ose me qera	2 copë
8	Kamiocine kapacitet me kapacitet mbajtes 0.8-1.5 ton	Pronesi ose me qera	1 copë
9	Damper me zinxhira gome	Pronesi ose me qera	1 copë
10	Palankola metalike gjatesi min 6ml	Pronesi ose me qera	10 ton
11	Sonde presioni te larte mbi 200 bar per pastrimin e tubacioneve.	Pronesi ose me qera	1 copë
12	Automjet teknologjik i specializuar per pastrimin e pusetave me bot uji me kapacitet mbajtes jo me te vogel se 4 ton	Pronesi ose me qera	1 copë
13	Makineri per ndertim mikrotunel D=400 mm me lazer, per kalim tubi	Pronesi ose me qera	1 copë
14	Autobetoniere vetengarkuese deri ne 3 m3	Pronesi ose me qera	1 copë
15	Gjenerator / Motogjenerator	Pronesi ose me qera	1 copë
16	Kontenier ndertimi stacionar (zyre)	Pronesi ose me qera	1 copë
17	Paisje topografike Totalstation/GPS	Pronesi ose me qera	1 copë
18	Pompë uji për pastrim	Pronesi ose me qera	1 copë
19	Rimorkiator per transport mjetes me kapacitet mbajtese jo me te vogel se 25 ton	Pronesi ose me qera	1 cope
20	Kamion vetëshkarkues me masë maksimale të autorizuar (25-32) Ton	Pronesi ose me qera	1 cope

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar. Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit:

- certifikatën e pronësisë;
- lejen e qarkullimit;
- certifikatën e kontrollit teknik;
- siguracionin;
- certifikate transporti lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore dhe fotot përkatëse;

Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fatura tatimore përkatëse fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjetet e marra

me qira të paraqitet kontrata përkatëse materiale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

- kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jete e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plote të punimeve.

- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

- Operatori/Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, nuk janë të angazhuara në procedurat e shpallura fitues nga autoriteti kontraktor dhe do të jene të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh gjithashtu edhe kombinimet e mundshme të punës së mjeteve në kantjere në të cilat është e shpërndarë puna objekt prokurimi. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas

- VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata:

a. Certifikatë: ISO 9001/2015 “Sistemi i Menaxhimit të cilësisë “

Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte të cilësisë, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

b. Certifikatë: ISO 45001/2018 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës”

Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes mundeson qe çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

- a. Certifikatë: ISO 14001:2025 “Sistemi i manaxhimit të ambientit” e velfshme ose ekuivalente.

Argumentimi: ISO 14001:2015 është një standard ndërkombëtar që ka të bëjë me menaxhimin e mjedisit dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullatore për mbrojtjen e mjedisit. Kjo certifikatë siguron që kompania ndërtuese ka implementuar praktika dhe sisteme për të menaxhuar ndikimet mjedisore të punimeve, si ndotja e ajrit, ujërave dhe menaxhimi i mbetjeve.

2.5 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave”

IV. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punët objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Kujdes! Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtim orë kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim: Në rastet kur citohet në dokumentet e tenderit të ngarkuara në SPE termi “cilësia e parë” ose “cilësi e I-rë” ose ndonjë “markë”, ky përcaktim të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

Njësia e Prokurimit